



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

DT 12-07-2018
NR 193 PRÖ

Nr.408 Regjistri Themeltar
Data e regjistrimit 04.06.2018

Nr.5934Vendimi
Data 22.06.2018

VENDIM
PËR RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Në Tiranë sot më datën 22.06.2018, unë **Julian HAXHIU** gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e personit të autorizuar, Roland Përmeti dhe Vojo Malo për regjistrimin e personit juridik të shoqatës Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar,

KONSTATOVA

Se kërkesi kërkon të regjistrojë si person juridik të shoqatës Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar, me seli në adresën, Rr. "Muhamet Gjollësja", Sheshi "Mustafa K. Atatürk", Tiranë, me kohëzgjatje të pacaktuar.

Roli i Komiteti Olimpik Kombëtar është të:

Promovojë parimet themelore dhe vlerat e Olimpizmit në Shqipëri në fushën e sportit dhe edukimit sportiv duke organizuar programe edukimi në të gjitha nivelet e shkollave, instituteve të edukimit fizik dhe universiteteve si dhe duke inkurajuar krijimin e instituteve të dedikuara edukimit Olimpik, të tilla si Akademia Olimpik Kombëtare (AOK), Muzeu Olimpik dhe programe të tjera kulturore të lidhura me Lëvizjen Olimpikë [Kapitulli 4 "Komitetet Olimpikë Kombëtare", paragrafi 28, Pika 2.1 e KO].

Sigurojë respektimin dhe zbatimin e Kartës Olimpikë në të gjithë vendin dhe të kërkojë respektimin e rregullave që drejtojnë sportet olimpikë, siç janë përcaktuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON) [Kapitulli 4 "Komitetet Olimpikë Kombëtare", paragrafi 28, Pika 2.2 e KO].

Inkurajojë zhvillimin e performancës së lartë në sport si dhe sportin për të gjithë [Kapitulli 4 "Komitetet Olimpikë Kombëtare", paragrafi 28, Pika 2.3 e KO].

Organizojë dhe marrë pjesë në formimin e kuadrove drejtues, zyrtarëve dhe teknikienëve të organizmave sportive duke organizuar kurse e siguruar që këto kurse kontribuojnë në propagandimin e parimeve themelore të Olimpizmit [Kapitulli 4 "Komitetet Olimpikë Kombëtare", paragrafi 28, Pika 2.4 e KO].

Luftojë ndaj çdo forme diskriminimi dhe dhune në sport [Kapitulli 4 "Komitetet Olimpikë Kombëtare", paragrafi 28, Pika 2.5 e KO].

do të ishte në kundërshtim me Kartën Olimpikë [Kapitulli 4 "Komitetet Olimpikë Kombëtare", paragrafi 28, Pika 5 e KO].

Selia e Shoqatës Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar do të jetë në adresën, Rr. "Muhamet Gjollëshë", Sheshi "Mustafa K. Atatürk", Tiranë.

Shoqata "Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar" do t'a ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.

Organet drejtuese të Shoqatës janë:

1. Asambleja e Përgjithëshme, si organ vendimmarrës.
2. Komiteti Ekzekutiv, si organ ekzekutiv.
3. Presidenti dhe Zv/Presidenti.

President i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqipëtar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme Zgjedhore datë 30 Qershor 2017 është zgjedhur Viron Bezhani.

Kërkesa është gjetur e bazuar në ligj dhe në statutin e shoqatës, dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit 8789 datë 07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" të ndryshuar dhe ligjin nr 8789 datë 07.05.2001, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", të ndryshuar.

VENDOSA :

Pranimin e kërkesës

Regjistrimin si person juridik të Shoqatës Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar si organizatë joqeveritare, jofitimprurëse me anëtarësi, me afat të papërcaktuar kohor.

Selia e Shoqatës Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar do të jetë në adresën, Rr. "Muhamet Gjollëshë", Sheshi "Mustafa K. Atatürk", Tiranë.

Shoqata "Komiteti Olimpik Kombëtar Shqipëtar" do t'a ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.

Organet drejtuese të Shoqatës janë:

1. Asambleja e Përgjithëshme, si organ vendimmarrës.
2. Komiteti Ekzekutiv, si organ ekzekutiv.
3. Presidenti dhe Zv/Presidenti.

President i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqipëtar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme Zgjedhore datë 30 Qershor 2017 është zgjedhur Viron Bezhani.

Urdhërimin e zyrës së Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse të bëjë shënimeat përkatëse në skedën e kësaj OJF-je .

Datë 22.06.2018

